



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria-Vlada-Government*

**MINISTRIA PËR DIALOG**

---

# Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për Dialogun e Brukselit

*/periudha 2014 - 2018/*

**Edita Tahiri, Ministre për dialog**

Prishtinë, 15 janar 2015

**Përmbajtja:**

1. Programi politik, parimet kryesore, parimet e panegociueshme
2. Lobizimi diplomatik për dialogun
3. Strategjia e dialogut
4. Fushëveprimtaria e mekanizmit për dialog
5. Mekanizmi negociator dhe Shtimi i kapaciteteve
6. Buxheti për dialog
7. Transparenca dhe llogaridhënia
8. Plani vjetor për 2015

## 1. Programi politik

Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të prioriteteve të politikës së jashtme, do të vazhdoj të jetë e përkushtuar në Dialogun e Brukselit me qëllim të normalizimit të marrëdhënieve fqinjësore mes Republikës së Kosovës dhe të Serbisë, si dy shtete të pavarura dhe sovrane, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe mbështetjen e fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se Dialogu i Brukselit është një angazhim diplomatik në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe politikat e jashtme të sajë që kontribuon për përmirësimin e jetës së qytetarëve, forcimin e sovranitetit shtetëror të Kosovës, promovimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe për realizimin e vizionit euro-atlantik të Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian dhe strukturat euro-atlantike.

Qeveria e Republikës së Kosovës vlerëson se angazhimi në Dialogun e Brukselit kontribuon drejtpërsëdrejti për plotësimin e standardeve evropiane për integrimin e shtetit të Kosovës në Bashkimin Evropian sepse dëshmon përkushtimin e shtetit tonë për paqe dhe stabilitet në rajon përmes parimeve evropiane për fqinjësinë e mirë dhe bashkëpunimin rajonal, si ndër kriteret kryesore të Kopenhagës për anëtarësimin e vendeve në Bashkimin Evropian.

Qeveria e Republikës së Kosovës zotohet se do të angazhohet fuqishëm të çojë përpara qëllimet e shtetit tonë në këtë dialogë mbi një platformë të qartë objektivash dhe parimesh mbi ruajtjen dhe mbrojtjen e interesave nacionale, të mbrojtjes së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të respektimit të Rezolutave të Kuvendit dhe të avancimit të synimeve tona për integritet euro-atlantike.

Qeveria e Republikës së Kosovës do të ketë një qasje serioze dhe konstruktive në Dialogun e Brukselit në përputhje me kompetencat dhe përgjegjësitë e saja kushtetuese duke qenë në bashkëpunim të plotë me institucionet e tjera të shtetit të Kosovës, në pajtim me Kushtetutën e vendit.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka pranuar obligimin ndërkombëtar për të hyrë në dialogun ndërshtetëror midis Republikës së Kosovës dhe të Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian që nga viti 2011, duke marrë për bazë konfirmimin e legjitimitetit ndërkombëtar të Deklaratës për pavarësinë e Kosovës të datës 17 shkurt 2008 nga ana Gjykatës Ndërkombëtare për Drejtësi më 22 korrik 2010, duke respektuar Rezolutën së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, A/RES/64/298 të datës 9 shtator 2010, dhe në

përputhje me kompetencat kushtetuese të Qeverisë për të ushtruar sovranitetin shtetëror në politikën e jashtme të vendit sipas nenit 93, pika 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me mbështetjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës përmes rezolutave të saja.

Qeveria e Republikës së Kosovës njeh dhe vlerëson lartë rezultatet e deritashme të arritura në Dialogun e Brukselit, Marrëveshjen e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve të datës 19 prill 2013 të ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Marrëveshjet e Dialogut teknik (2011-2012), të cilat kanë kontribuar dukshëm në forcimin e sovranitetit shtetëror të Kosovës, avancimin e subjektivitetit të saj ndërkombëtar dhe integrimin evropian të Kosovës.

Dialogu i Brukselit ka kontribuar në synimin për forcimin e pozicionit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës, në vendosjen e marrëdhënieve kontraktuale mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian përmes Marrëveshjes Stabilizim Asocim, në rritjen e numrit të njohjeve, afrimin e metejmë me NATO-n, anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe rajonale. Aftësia dhe serioziteti i Qeverisë së Republikës së Kosovës në këtë dialog ka kontribuar për përmirësimin e imazhit të shtetit të Kosovës duke e shquar si shtet të aftë për të zhvilluar marrëdhënie ndërkombëtare, për të forcuar aleancën euro-atlantike me SHBA dhe BE-në dhe si partner serioz në sfidat globale politike dhe të sigurisë në botë dhe rajon.

Qeveria konsideron se gjatë katër viteve të këtij procesi intensiv paqësorë, si dhe duke iu falënderuar ndërmjetësimit konsekuent nga ana e Bashkimit Evropian dhe mbështetjes së plotë nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve me një të kaluar armiqësore janë duke u transformuar në një model evropian të bashkëpunimit. Në të njëjtën kohë, marrëveshjet e arritura kanë kontribuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve në planin politik e të sigurisë dhe atë socio-ekonomik, të lëvizjes së lirë dhe sigurisë, në integrimin e qytetarëve serbë të pjesës veriore në institucionet e shtetit të Kosovës, në shpërbërjen e strukturave paralele të Serbisë në Kosovë dhe ndaljen e ndërhyrjeve të Serbisë në fushat ku janë arritur marrëveshjet, ndërkohë Kosova ka konsoliduar më tej sovranitetin territorial në gjithë vendin.

Qeveria shpreh bindjen e thellë se çelësi i suksesit të Dialogut të Brukselit është te zbatimi i plotë dhe efektiv i të gjitha marrëveshjeve, të cilën Kosova e ka dëshmuar duke përmbushur me konsekuencë obligimet e saja zbatuese. Qeveria vlerëson se mungesa e vullnetit politik të Serbisë për fqinjësi të mirë dhe marrëdhënie evropiane me shtetin e Kosovës, ka qenë faktori kryesor për moszbatimin, zvarritjet dhe herë herë shkeljen e marrëveshjeve nga ana e Serbisë, për të cilat Qeveria në vazhdimësi ka

kërkuar dhe kërkon angazhim më të fuqishëm të Bashkimit Evropian si ndërmjetëse dhe garantuese e këtij procesi.

### Parimet kryesore të dialogut

Parimet kryesore të dialogut të Brukselit kanë për bazë të drejtën ndërkombëtare dhe standardet evropiane për fqinjësi të mirë mes shtetesh që kanë pasur një histori lufte të shkaktuar nga agresioni i Serbisë në Kosovë dhe shtypja dhe gjenocidi i bërë ndaj Kosovës dhe shqiptarëve, në rrethanat e zhbërjes së ish-Jugosllavisë dhe lindjes së shtatë shteteve të reja.

Qeveria e Republikës së Kosovës në dialogun e Brukselit, si edhe deri tani, do të bazohet në këto parime kryesore:

1. Dialogu i Brukselit do të përfshijë vetëm çështjet e interesit të ndërsjellë mes dy shteteve, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e shtetit të Kosovës, pavarësinë, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Kosovës
2. Respektimi i të drejtës ndërkombëtare dhe parimeve euro-atlantike për fqinjësi të mirë mes shtetesh që kanë pasur një histori lufte të shkaktuar nga agresioni i Serbisë në Kosovë
3. Respektimi i ndërsjellë i sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial mes dy shteteve
4. Njohja e ndërsjellë mes dy shteteve
5. Mosndërhyrja në sovranitetin e njëra tjetrës dhe zhbërja e plotë e gjithë strukturave paralele të Serbisë në Kosovë
6. Respektimi i kufirit ndërshtetëror mes dy shteteve /Demarkacioni kufirit ndërshtetëror në mes të Kosovës dhe Serbisë
7. Vendosja e bashkëpunimit ndërshtetëror në fusha me interes të ndërsjellë sipas standardeve evropiane dhe euroatlantike
8. Zgjidhja e çështjeve në kuadër të Reparacioneve të luftës dhe Sukcesionit, në bazë të drejtës ndërkombëtare

## 9. Respektimi i ndërsjellë i të drejtave të minoriteteve në të dyja shtetet

### Parimet e panegociueshme

Qeveria e Republikës së Kosovës nuk do të shkel në asnjë rast parimet e panegociueshme, siç janë:

1. Statusi i Kosovës është i zgjidhur. Kosova është shtet i pavarur, sovran me integritet territorial të paprekshëm dhe kushtetutë moderne të njohur ndërkombëtarisht. Gjykata Ndërkombëtare për Drejtësi ka konfirmuar ligjshmërinë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës më 22 korrik 2010. Shteti i Kosovës është njohur nga pjesa më e fuqishme e bashkësisë ndërkombëtare, nga 108 shtete në mesin e të cilëve SHBA, shumica e shteteve të Bashkimit Evropian, shtetet e rajonit e më gjerë. Kosova është anëtare e Bankës Botërore, Fondit Monetar Ndërkombëtar, BERZH, Komitetit Olimpik Botëror, Këshillit për Bashkëpunimin Rajonal (RCC), SEECI etj. dhe procesi i njohjeve është në rritje.
2. Sovraniteti dhe integriteti territorial i Republikës së Kosovës është i pacenueshëm, i patjetërsueshëm dhe i pandashëm dhe mbrohet me të gjitha mjetet e përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.
3. Rregullimi i brendshëm i vendit është kompetencë sovrane e institucioneve shtetërore, e rregulluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
4. Plani i Ahtisarit është platforma për rregullimin e të drejtave dhe garancive për komunitetet dhe i njëjti është integruar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Plani i Ahtisarit ofron kompetenca të veçanta për komunitetin serb, dhe si i tillë madje është më shumë se që ofron e drejta ndërkombëtare për minoritetet.

Qeveria e Republikës së Kosovës ka respektuar dhe do të respektoj këto parime bazë sepse janë në pajtim me Kushtetutën e shtetit tonë që thotë se “se shteti pavarur dhe sovran Kosovës zotohet të kontribuojë në stabilitetin e rajonit dhe të mbarë kontinentit evropian, duke krijuar marrëdhënie të fqinjësisë dhe të bashkëpunimit të mirë me të gjitha shtetet fqinje”

Qeveria duke qenë e vetëdijshme se shumë punë mbeten për tu bërë në të ardhmen, do të angazhohet fuqishëm për zbatimin e plotë dhe efektiv të gjitha Marrëveshjeve të Brukselit si dhe për arritjen e marrëveshjeve të reja në fusha me interes për vendin sipas parimeve të reciprocitetit në bashkëpunime bilaterale dhe duke respektuar parimet e kryesore dhe parimet e panegociueshme.

Marrëveshja e Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore mes dy shteteve, e nënshkruar nga kryeministrat e të dyja shteteve dhe përfaqësuese së lartë të BE-së, më 19 prill 2013 në Bruksel, me ndërmjetimin e BE-së, është vlerësuar ndërkombëtarisht si një marrëveshje historike sepse ka vënë bazat e fqinjësisë së mirë mes të dyja shteteve sipas parimeve evropiane. Kjo marrëveshje ka përcaktuar obligime ndërkombëtare në aspekte shumë të rëndësishme siç janë: funksionimit legal dhe integrimi në fushat e sigurisë, drejtësisë, të funksionimit legal të komunave dhe rrjedhimisht të një procesi integrues të qytetarëve serb të pjesës veriore në institucionet e shtetit të Kosovës, shuarjen e strukturave ilegale serbe, të vendosjes së ligjit në grumbullimin e taksave doganore e përparime tjera. Në planin ndërkombëtar, kjo marrëveshje ka sanksionuar zotimin e të dyja shteteve për të mos penguar njëra tjetrën në rrugën e integritit evropian. Në funksion të krijimit të mirëbesimit dhe integritit të pjesëtareve të komunitetit serb, institucionet shtetërore të Kosovës kanë krijuar një Fond për zhvillim për komunat veriore dhe Ligjin për amnistinë.

Marrëveshjet e Dialogut Teknik, gjithsejtë shtatë, janë marrëveshjet e para të nënshkruara në historinë mes dy shteteve, me ndërmjetësimin e BE-së dhe pjesëmarrjen e SHBA-ve në tryezën bisedimeve. Këto marrëveshje kanë vënë bazat e reciprocitetit ndërshtetëror në bashkëpunimin mes dyja vendeve ku përfshihen njohja e ndërsjellë e dokumenteve shtetërore dhe lëvizja e lirë (Marrëveshja për lëvizjen e lirë); njohja e kufirit ndërshtetëror dhe vendosja e bashkëpunimit ndërkufitar (Marrëveshja e IBM-it dhe Protokollit teknik); tregtia e lirë dhe njohja e ndërsjellë e vulave doganore (Marrëveshja për njohjen e ndërsjellë të vulave doganore); njohja e ndërsjellë të diplomave universitare (Marrëveshja për diploma). Po ashtu, të nisjes së riparimit të pasojave të luftës përmes Marrëveshjes për kthimin e plotë të regjistrave civil të marrë dhunshëm gjatë luftës (dokumente origjinale të skanuara dhe vërtetuar nga BE) që tashmë janë kthyer në tërësi, të Marrëveshjes për kthimin e dokumentacionit kadastral. Në planin ndërkombëtar, të heqjes së pengesave për pjesëmarrjen shtetërore të Kosovës dhe antarësimin në organizata rajonale (Marrëveshja për bashkëpunimin rajonal). Po ashtu, nga Dialogu teknik kanë dal draft marrëveshjet për çështjet e telekomunikacionit dhe energjisë që janë finalizuar gjatë dialogut për normalizim. Të

gjitha marrëveshjet, nga të dy fazat e dialogut, kanë sjellë njohjen reciproke mes dy shteteve në fushatë ku janë arritur marrëveshjet, dhe kanë pasur ndikime pozitive në përmirësimin e jetës së qytetarëve në planin socio-ekonomik, të lirisë së lëvizjes dhe sigurisë.

Në përgjithësi, Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se ka pasur progres të mirë në dialogun e Brukselit gjatë periudhës së kaluar. Progresi në procesin e zbatimit të marrëveshjeve të arritura është i nivele të ndryshme për fushat të ndryshme ku janë arritur marrëveshjet. Progres i mirë është arritur në çështjet e funksionimit ligjor dhe demokratik të katër komunave veriore, çështjet e sigurisë për pjesën e policisë, menaxhimi i integruar i kufirit (IBM), liria e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave, librat e regjistrimit civil, e cila është përfunduar, mbledhja të hyrave doganore, Fondi për zhvillim, energji, bashkëpunimi rajonal.

Megjithatë, ka nevojë një progres substancial për të finalizuar planet e zbatimit dhe zbatimin në çështjet vijuese: çështjet e drejtësisë, ku tashmë plani për zbatim është dakorduar; çështjet e sigurisë për pjesën e shuarjes së të ashtuquajturës "struktura të mbrojtjes civile serbe" ku ekziston plani për zbatim por nuk ka përparime në zbatim; çështjet e telekomunikacionit ku marrëveshja për zbatim ende nuk është nënshkruar, sigurimin e automjeteve ku pritet së shpejti të nënshkruhet marrëveshja si dhe zhvillimin e planit të zbatimit (draft statuti) për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, zbatimi i marrëveshjes së heqjes së barrikadës nga Ura e Ibrit dhe të tjerave nga ana e BE-se. Ndërkaq, marrëveshjet për njohjen reciproke të diplomave universitare dhe dokumenteve kadastralë janë në pritje të zbatimit. Më hollësisht, gjendja në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit është paraqitur në Raportin e fundit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për periudhën Janar-Shtator 2014, të dorëzuar në BE më 10 tetor 2014.

Qeveria e Republikës së Kosovës, në periudhën vijuese, angazhimet e saja do ti përqendroj në disa nivele të procesit të dialogut të Brukselit: zbatimi i plotë dhe efektiv i të gjitha marrëveshjeve, mbyllja e çështjeve të mbetura/finalizimi i planeve për zbatim, arritja e marrëveshjeve të reja.

Sa i takon zbatimin të marrëveshjeve, Qeveria do të kërkoj nga Bashkimi Evropian angazhime shtesë në këtë drejtim.

Në kuadër të çështjeve të mbetura, Qeveria do ti jep prioritet çështjeve të drejtësisë, sigurisë, asociacionit, telekomunikacionit /kodit telefonik, etj.

Në kuadër të arritjes së marrëveshjeve të reja, Qeveria do të ketë për bazë Dokumentin mbi temat në fazën vijuese, të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës e ka dorëzuar në Bashkimin Evropian në mars të 2014, dokument ky i mbështetur në parimet e të drejtës



ndërkombëtare për fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim mes dy shtetesh, ku përfshihen të gjitha çështjet me interes për vendin tonë duke përfshirë marrëveshjet e mundshme në fusha të ndryshme, çështjet e reparacionit të luftës dhe suksesioni, që nga të pagjeturit dhe dhunimet e grave gjatë luftës deri të kompensimet e dëmeve të luftës dhe garancionet, dhe kërkesa që dialogu duhet të përfundoj me njohjen e ndërsjellë mes të dyja shteteve.

Qeveria mbetet e përkushtuar për zbatimin e marrëveshjeve nga dialogu i Brukselit përdërisa mirëpret dhe kërkon nga Bashkimi Evropian një angazhim më të fuqishëm për ta detyruar Serbinë që të përmbush obligimet zbatuese që njëkohësisht janë obligime ndërkombëtare.

Qeveria e Republikës së Kosovës konsideron se dialogu i Brukselit është një prej standardeve evropiane për fqinjësinë e mirë të cilin të dyja shtetet duhet ta plotësojnë në rrugëtimin e tyre për Bashkimin Evropian. Qeveria vlerëson lartë kushtëzimin e Serbisë me kapitullin 35 në procesin e negociatave për integrimin evropian, që kërkon nga Serbia normalizimi e plotë të marrëdhënieve shtetin e Kosovës përmes një marrëveshje ndërkombëtare juridikisht të obligueshme.

Qëllimi kryesor i Qeverisë është vendosja e marrëdhënieve ndër fqinjësore mes Kosovës dhe Serbisë me garancat e BE-së, si dy shtete aspirantë për anëtarësim në BE, që ofron një mundësi për të mbyllur kapitullin e konflikteve dhe për të hapur kapitullin e paqes në mes të dy shteteve dhe madje edhe në mes të dy kombeve, shqiptarëve dhe serbëve.

Qeveria e Kosovës konsideron se dialogu i Brukselit duhet të përfundoj me njohjen reciproke mes dyja shteteve, Kosovës dhe Serbisë, para pranimit të tyre në Bashkimin Evropian, rezultat ky që duhet të mbështetet nga të gjitha vendet e anëtare të Bashkimit Evropian, me qëllim të forcimit të paqes dhe stabilitetit në rajon dhe forcimit të një Evrope të tërë dhe të lirë.

Qeveria do të vazhdoj të bashkëpunoj ngushtë me partnerët strategjik, SHBA-të dhe BE-në dhe vendet e anëtare të saj dhe gjithë vendet tjera përkrahëse dhe mospërkrahëse për një përfundim të suksesshëm të këtij procesi me rëndësi ndërkombëtare dhe rajonale.

## **2. Lobizimi diplomatik për dialogun**

Duke marrë parasysh se bashkësia ndërkombëtare i jep rëndësi të madhe Dialogut të Brukselit si një proces në funksion të paqes dhe sigurisë në rajon, dhe madje ky dialog gjithnjë e më shumë shihet si një model pozitiv për të zgjidhur çështjet e hapura mes vendeve të rajonit e më gjerë, roli konstruktiv i Kosovës në këtë proces i vlerësuar ndërkombëtarisht është një aset i çmuar, një argument i fuqishëm që Qeveria e Kosovës do të vazhdoj ta shfrytëzojë në diplomaci në favor të forcimit të subjektivitetit ndërkombëtar të shtetit të Kosovës dhe rritjes së numrit të njohjeve.

Në planin diplomatik, Qeveria do të vazhdoj të lobizojë në planin bilateral dhe multilateral për të ndriçuar rolin konstruktiv të Kosovës në dialogun e Brukselit duke kërkuar që konstruktiviteti i Kosovës të shpërblehet me qartësinë më të madhe të ardhmërisë së sajë evropiane dhe përsheptimin e integritit evropian për Kosovën. Në këtë kuadër, do të kërkohet që sa më shpejtë të nënshkruhet Marrëveshja Stabilizim Asocim (MSA) mes Kosovës dhe BE-së, për të cilën BE ka marrë vendim në vitin 2011, pas arritjes së pesë marrëveshjeve të para mes Kosovës dhe Serbisë. Po ashtu, do të kërkohet shpejtimi liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës, ndërsa në fazat tjera përsheptimi i integritit të Kosovës në BE. Ndër caqet e lobimeve do të jenë rritja e numrit të njohjeve dhe sidomos nga pesë vendet anëtare të Bashkimit Evropian të cilat ende nuk e kanë njohur Kosovën, që sa më shpejtë ta njohin shtetin e Kosovës, si dhe të mos pengojnë MSA-në për Kosovën, në të mirë të paqes dhe stabilitetit në rajon. Diplomacia në mbështetje të dialogut do të shërbejë jo vetëm për vet suksesin e dialogut por edhe në rritjen e numrit të njohjeve dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe rajonale duke përfshirë, BE, NATO, OKB-në.

## **3. Strategjia e dialogut**

Qeveria e Republikës së Kosovës do të zhvilloj një strategji për negociim duke u bazuar në Dokumentin për Strategjinë Nacionale për Dialogun e Brukselit (2011) e cila përcakton vijat e kuqe të dialogut në respektim të plotë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, pacenueshmërinë e pavarësisë, sovranitetit dhe integritetit territorial dhe të rregullimit të brendshëm të shtetit të Kosovës.

#### **4. Fushëveprimtaria e mekanizimit të dialogut**

Fushëveprimtaria e dialogut ka katër shtylla kryesore siç janë: negociimi, zbatimi dhe monitorimi, ndërlidhja me agjendën evropiane dhe politikat e jashtme dhe ligjshmëria e procesit.

##### **1. Negocimi**

- Përgatitja e Agjendës për prioritetet e Qeverisë në Dialogun e Brukselit
- Negocimi me BE-në që këto çështje të përfshihen në Agjendën e dialogut të Brukselit
- Negocimi i marrëveshjeve, në nivelin politik dhe teknik, që përfshinë përgatitjen e platformës dhe strategjisë për negociata dhe procesin e bisedimeve/negocimit në dialogun e Brukselit

##### **2. Zbatimi dhe Monitorimi**

- Negocimi i marrëveshjeve për zbatim/planeve për zbatimin të marrëveshjeve të arritura, që përfshinë përgatitjen e platformës dhe strategjisë për negociata për zbatimin dhe procesin e bisedimeve në dialogun e Brukselit
- Zbatimi i marrëveshjeve dhe planeve për zbatim në përmbushje të obligimeve zbatuese të palës tonë, në bashkëpunim me dikasteret e qeverisë dhe agjencionet kompetente publike
- Monitorimi i zbatimit të marrëveshjeve, që përfshinë përcjelljen e gjendjes në zbatim, të shkeljes së marrëveshjes dhe afateve të parapara në planin për zbatim nga pala serbe, të cilësisë së zbatimit dhe raportimit në Bruksel për këto shkelje me qëllim të evitimit të tyre

##### **3. Ndërlidhja me Agjendën evropiane dhe politikat e jashtme**

- Raportimi i rregullt në BE për gjendjen në zbatimin e marrëveshjeve, në mënyrë periodike dhe në baza ditore, sipas dinamikave të shkeljeve të marrëveshjeve dhe planeve për zbatim, për të njoftuar dhe kërkuar angazhimin e BE-së për zgjidhjen e këtyre problemeve
- Ndërlidhja e avancimeve në integritetin evropian për Kosovën, duke ndriçuar performancat e palës së Kosovës në dialog dhe kërkesa që BE-ja ta vlerësoj dhe përkthej në shpërblim për avancimin e shtetit tonë në integritetin evropian.
- Raporti për progresin në dialog të jetë i përfshirë në mënyrë reale në Raportin e progresit të BE për Kosovën

- Përcjellja e procesit të negociatave për anëtarësimi të Serbisë, në kuadër të kushtëzimit të sajë me Dialogun e Brukselit dhe në veçanti kapitullin 35, duke vënë në dijeni BE-në për shkeljet e Marrëveshjeve

#### **4. Ligjshmëria e procesit**

- Procesi i dialogimit/negociatave dhe të marrëveshjet e arritura duhet të jenë në përputhshmëri me Kushtetutën dhe Ligjet e Kosovës, që realizohet përmes procesit të këshillimeve dhe verifikimeve ligjore

### **5. Mekanizmi negociator dhe Shtimi i kapaciteteve**

Mekanizmi negociator është një strukturë e organizuar e cila përkufizohet në Platformën shtetërore për Dialogun Teknik të Brukselit të vitit 2011.

Për të përballuar me sukses agjendën dhe sfidat komplekse të këtij dialogu, ato ekzistuese dhe të tjerat që do të vijnë, Qeveria do të angazhohet për shtimin e kapaciteteve institucionale në këtë sektor. Fakti se Dialogu i Brukselit është një prej kushteve kryesore për integrimin evropian të dyja shteteve, me agjendën e sajë progresive si për nga çështjet e trajtuara dhe të tjerat që priten të jenë në agjendë, dhe kohëzgjatja dhe vijimësia që pritet të jetë e shtigjeve të gjata mbase deri në anëtarësimin e të dyja shteteve në Bashkimin Evropian, është e domosdoshme dhe me interes të ketë një strukturë të qëndrueshme, staf administrativ mbështetës krahas nivelit politik dhe vendimmarrës, që do të mund të ishte një ministri për dialog. Dialogu u Brukselit është një proces afatgjatë që dallon nga bisedimet tjera paqësore, në Rambuje dhe Vjenë, sepse ato janë zhvilluar brenda periudhave të caktuara kohore.

Aryeshmëria për krijimin e Ministrisë për dialogun bazohet në qëllimet institucionale për funksionimin më cilësor, kontinuitetin, memorien institucionale dhe ruajtjen e ekspertizës së fituar, që në periudhën e ardhshme mund të evitojë pasojat e ndryshimeve politike/qeveritare të cilat kanë krijuar humbjen e kuadrove të dialogut.

Duke qenë se dialogu pritet të vazhdoj deri në anëtarësimin e të dyja shteteve në BE, që orientimisht përfshinë një periudhë 8 deri 10 vjetë, me një parashikim optimistë, atëherë ka arsyeshmëri të bazuar për krijimin e Ministrisë së Dialogut, me një strukturë modeste dhe dinamike sipas rritjes së dinamikave në negocimin e marrëveshjeve të reja dhe rrjedhimisht të obligimeve zbatuese, monitoruese dhe raportimeve në BE.

Veprimtaria e deritashme negociatore është realizuar nga Zëvendëskryeministrja për politikë të jashtme dhe siguri nacionale Edita Tahiri e cila ka qenë kryenegociatore e Dialogut teknik 2011-2012. ZVKM Tahiri ka vazhduar detyrën e Kryenegociatores së

bisedimeve teknike edhe fazën e dytë të dialogut – të Dialogut politik në nivelin e Kryeministrave që ka filluar në vjeshtën e 2012. Kryenegociatorja zhvillon veprimtarinë negociatore për arritjen e marrëveshjeve. Çështjet e ndjeshme që nuk mund të dakordohen në negociatat e nivelit teknik kalojnë për negociim dhe aprovim në nivelin e KM-ve. Kryenegociatorja është pjesë e delegacionit në nivelin politik. Ka raste kur të dyja negociatat zhvillohen paralelisht ato teknike dhe politike, për të shpejtuar arritjen e marrëveshjeve. ZVKM Edita Tahiri dhe kabineti i sajë zhvillojnë veprimtarinë negociatore në bashkëpunim të ngushtë me KM, ZKM dhe ZPS si dhe në bashkëpunim me ministritë dhe agjencitë publike kompetente për fushatë që janë trajtuar në dialog. Puna e ZVKM Tahiri si Kryenegociatore është mbështetur nga grupet e ekspertëve të emëruar nga Ministritë dhe institucionet publike dhe në raste të caktuara kanë marrë pjesë vet ministrat dhe Drejtorët/Kryeshefat e institucioneve publike/agjencioneve.

Vendimmarrja në procesin e negociatave është realizuar në dy mënyra: vendimmarrja e bazuar në platformën negociatore dhe vendimmarrja për çështjet e ndjeshme.

Vendimmarrja nga platforma negociatore, të përgatitur paraprakisht nga ZVKM/Kryenegociatorja në bashkëpunim dhe aprovim me Ministrat e linjës ka qenë baza e kompetencave dhe vendimmarrjes së Kryenegociatores gjatë procesit të negociimit dhe arritjes së marrëveshjeve. Në raste të çështjeve të ndjeshme në bazë të vlerësimit të Kryenegociatores, vendimmarrja është realizuar në nivelin më të lartë, në përbërje të KM, ZVKM/Kryenegociatorja dhe Ministri apo Ministrat e linjës kompetentë për temën e negociuar në dialog.

Në dokumentin e Platformës shtetërore për Dialogun Teknik të aprovuar nga Qeveria janë të përshkruara kompetencat dhe organizimi strukturor, ku parashihen konsultat dhe raportimet të Presidentja dhe raportimet e rregullta në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Po ashtu, janë përkufizuar edhe raportet me opozitën dhe shoqërinë civile sipas parimit të gjithë përfshirjes si dhe angazhimi i ekspertëve ndërkombëtar. Kjo strukturë ka funksionuar mjaft mirë gjë e cila shihet nga rezultatet e mëdha të dialogut në favorin e shtetit tonë.

Mirëpo, nga përvoja ime si udhëheqëse e këtij procesi kompleks, mendoj dhe propozoj që të krijohet një strukturë më e qëndrueshme, që do të përballoj sfidat dhe dinamikat në rritje. Dialogu është një proces i ndjeshëm dhe dinamik, që ngërthen në vete numër të madh variablash ( çështjesh, nënçështjesh,.., etj.) brenda fushave të diskutuara, që krijon vështirësi në transferin e të gjithë procesit tek aktorët e rinjë, aq më shumë që negociatat shoqërohen me konfidencialitet, që është një faktor qenësor për suksesin e tij. Kështu, derisa numri i marrëveshjeve të arritura ka mbërri mbi njëzetë, së bashku me planet për zbatim (që janë po ashtu marrëveshje të negociuara dhe dakorduara) dhe

marrëveshje për nënçështjet që derivojnë nga marrëveshjet apo planet për zbatime, numri i përgjithshëm i marrëveshjeve mbërrin mbi pesëdhjetë sosh.

Në fakt ky proces në mënyrë metaforike mund të shihet si një piramidë ku në krye të piramidës janë marrëveshjet bazë dhe piramida vazhdimisht vjen e zgjerohet në bazë të nënçështjeve që derivojnë nga të parat. Me një shpjegim tjetër, vendosja e një bashkëpunimi ndërshtetëror me Serbinë sipas standardeve evropiane dhe shuarja e gjithë mozaikut të strukturave ilegale serbe të vendosura që nga viti 1999, në kushtet e mosnjohjes reciproke, nxjerrë pengesa të natyrave të ndryshme politike, dhe për secilën prej tyre duhet të gjendet zgjidhja për të bërë që marrëveshja të funksionoj.

Vlenë të theksohet që gjatë procesit të zbatimit paraqiten shkelje të formave të ndryshme nga ana e Serbisë që kërkojnë trajtim shtesë. Më tej për të raportuar në Bashkimin Evropian për gjithë këtë mozaik shkeljesh është tepër me rëndësi, sepse siç dihet Serbia është e kushtëzuar me zbatimin e marrëveshjeve në rrugën e sajë evropiane.

Nëse shtrohet pyetja se si ka qenë e mundur të përballohen gjithë këto detyra dhe përgjegjësi, mund tju them me përgjegjësi të plotë se të gjithë zyrtarët që kanë qenë të angazhuar në këtë proces, kanë treguar performanca të larta, përkushtim shtetëror dhe punë pa orar. Mirëpo, një dinamikë e tillë nuk mund të përballohet më tej, kërkojnë kushte më të mira, si për nga rritja e numrit të stafit, ashtu edhe pagesa për punë jashtë orarit, e paraparë me ligjet e vendit.

Krahas Ministrisë për Dialogun duhet të krijohet dhe një Komitet ndërministror për funksionalizimin e katër komunave veriore, të cilat pas zgjedhjeve lokale 2013 kanë hyrë një proces të funksionalizimit legal dhe demokratik me konstituimin e organeve legale komunale dhe miratimin e statuteve konform ligjeve të Kosovës. Komisioni Ndërministror do të ishte një mekanizëm i cili po ashtu do të angazhohej për integrimin e qytetarëve serb të kësaj pjese në institucionet shtetërore të Kosovës, të cilët për shkaqe të njohura në një periudhë të caktuar kanë braktisur institucionet. Janë shumë sfida në këtë drejtim, që do të paraqiten në një dokument të veçantë.

## **6. Buxheti për dialog**

Duhet të alokohet një buxhet i veçantë për Dialogun e Bruskelit me qëllim të realizimit të programit qeveritar për këtë fushë.

Buxheti për dialog në periudhën e kaluar ka qenë i mbuluar nga ZKM, nuk ka pasur një buxhet të veçantë, përveç për vitin 2011. Përderisa mbështetja nga ZKM dhe vet KM ka

qenë e plotë, ky buxhet ka mbuluar vetëm udhëtime për stafin politik dhe civil të ZKM-së, ndërsa Ministritë dhe Agjencitë kanë marrë përsipër financimin e stafit të tyre përkatës.

Në proces janë vërejtur mangësi dhe kufizime në këtë model buxhetimi, duke qenë se ministri dhe agjenci të caktuara kohë pas kohe nuk kanë mundur të marrin pjesë në bisedime për shkak të mungesës së buxhetit për të cilën nuk kanë pasur linja buxhetore.

Po ashtu, mangësitë tjera kanë qenë të lidhura me moskompensimin e punës shtesë, duke qenë se para dhe gjatë bisedimeve të Brukselit punohet gati pa orar, duke përfshirë përgatitjen e platformave dhe strategjive për negociim, dhe vet dinamikat e dialogut, domosdo kërkon punë jashtë orarit.

## **7. Transparenca dhe llogaridhënia**

Negociatat në teori dhe praktik për të qenë të suksesshme kërkojnë respektimin e një shkalle të konfidencialitetit në këtë proces. Konfidencialiteti lidhet me vet ndjeshmërinë e procesit dhe që natyrisht pamundëson transparencën e plotë. Në periudhën e kaluar jemi angazhuar që të gjejmë një balancë mes kërkesave të qytetarëve, mediave, opinionit publik dhe shoqërisë civile në një anë dhe respektimit e parimit të konfidencialitetit në anën tjetër. Komunikimi me publikun është realizuar në forma të ndryshme, bashkëpunimi me mediat në këtë fushë, publikimi i marrëveshjeve në Website-in e ZKM, konferencat për shtyp pas çdo raundi dhe pas çdo marrëveshje, intervistat, pjesëmarrja në tryeza e konferenca vendore e ndërkombëtare, etj.

Në fazën vijuese, mendoj se transparenca duhet të rritet por me një kujdes të matur, duke marrë parasysh që ky proces ndryshon dhe avancohet deri në rezultatet përfundimtare përkatësisht marrëveshjet e arritura. Rritja e transparencës mund të realizohet duke vazhduar traditat e bashkëpunimit si dhe duke e pasuruar më tej, siç mund të jetë: duke hapur një website për dialogun, botimi i publikimeve për të dy fazat e dialogut, teknik dhe për normalizim, botimi i broshurave udhëzuese për qytetarët për të shfrytëzuar më mirë shërbimet që i ofrojnë marrëveshjet, etj.

Në aspektin e llogaridhënies duhet të vazhdojnë raportimet e rregullta në Kuvendin e Kosovës në bazë të parimeve të përcaktuara në Rezolutat e Kuvendit. Ky obligim mund të shtrihet më tej në takime me qytetarët në bashkëpunim me Kuvendet komunale dhe forma tjera për komunikim.

## 8. Planet vjetore

Planet vjetore të punës për dialogun hartohen bazuar Programin e Qeverisë dhe në këtë Program për dialogun, si dhe janë në dokumentë të veçantë.



Edita Tahiri

Ministre për dialog